



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 53/21 Prot.

Tiranë më 07.11.2024

V E N D I M

Nr. 53 Datë 07.11.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Arben Sefaj **Kryesues**
Denisa Sina **Relatore**
Suela Bulku **Anëtare**

Në datën 31.10.2024, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik Znj. Lediana Azemaj, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Z. Arben Mehmet Alik** , me funksion
Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e
Policisë Vendore Gjirokastrë.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar
dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit,
Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e
Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e
Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative
të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin
e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e
Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat
procedural të unifikuar”.

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoji gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatores së çështjes znj. Denisa Sina, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Z. Arben Mehmet Alike, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Arben Alike, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si “Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Policisë Vendore Gjirokastrë.
3. Subjekti i vlerësimit, Z. Arben Alike, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr.1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Arben Sefaj (Kryesues) Znj. Denisa Sina (Relator), dhe Znj. Suela Bulku (Anëtare).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr.1, datë 13.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Arben Alike.
6. Relatori i çështjes, Znj. Denisa Sina nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 17.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Më datë 18.07.2023 janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit e konkretisht:




- ✓ Me shkresën me nr.*** prot. datë 18.07.2023 është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI
- ✓ Me shkresën me nr. *** prot. datë 18.07.2023 është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale.
- ✓ Me shkresën me nr. *** prot. datë 18.07.2023 është dërguar formulari mbi deklaratën e kontrollit të figurës.

8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 17.07.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

-  vlerësimin e pasurisë;
-  kontrollin e figurës;
-  vlerësimin e aftësive profesionale.

12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklaramit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar
- g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

13. Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

-  *Deklarata e Pasurisë,*

- + Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- + Formulari i Vlerësimit Profesional
- + Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,
- + Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- + Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- + Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- + Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- + provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- + ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

14. Trupa e vlerësimit, më datë 24.10.2024 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Arben Alike, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - + Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - + Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

16. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

17. ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i

ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit Z. Arben Alika.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Arben Alika, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 31.10.2024, subjekti i vlerësimit Arben Alika kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin më datën 07.11.2024, për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Z. Arben Alika, ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

I. VLERËSIMI I PASURISË

19. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, “Vlerësimi i pasurisë”, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

20. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Arben Alika ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 09.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr. ***, index 2023.

21. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32, dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

22. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

23. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin

e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

24. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim".

Neni 1 citon; "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë".

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si edhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;

25. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim; Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

26. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, me shkresën nr. *** datë 19.12.2023 "Dërgohet akti i përfundimit të plotë të kontrollit të Deklaratës së pasurisë për Vlerësimin Kalimtar", në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin e administruar, konstatohet se, për subjektin e vlerësimit z. Arben Alika:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk është kryer deklarim i rremë,
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

27. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005,

"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, është deklaruar:

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT ARBEN ALIKA

I. Deklarimi i Pasurive:

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr.1.

Autoveturë, marka Mazda, vit prodhimi 2012, me targa AA***SV. Përfituar me kontratë dhurimi nr. rep. ***, nr. kol.***, datë 15.06.2022 në vlerën 3000 euro. Zotëron 100%.

Subjekti ka dorëzuar:

- Kontratë dhurimi automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.06.2022. Palë dhuruese B.A dhe palë pranuese e dhurimit Arben Alika. Pala dhuruese B.A ka deklaruar se i dhuron vëllait të tij Arben Alika, automjetin e tij Mazda me targë AA***SV, me vlerë tregu 3.000 euro.
- Deklaratë nga B.A, dt. 16.09.2023, ku konfirmohet se me cilësinë e administratorit të shoqërisë "****" shpk., me NIPT K797***D, deklaron se fitimi i shoqërisë për vitin 2022 ka rezultuar 2.331.483 lekë dhe në vitin 2021 në shumën l. 523.792 lekë. Bashkëlidhur formulari i deklaramit dhe pagesës së tatimit mbifitimin për subjektin "****" shpk., për vitin 2021 dhe 2022.
- Konfirmohet fitimi i realizuar për vitin 2021, në shumën l.792.696 dhe tatimi i paguar në shumën 268.904 lekë. Fitimi i realizuar në vitin 2022 në shumën 2.742.898 lekë dhe tatimi i paguar 411.435 lekë. Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për subjektin "****" shpk., me NIPT K797***D, regjistruar në dt. 14.11.2007 me administrator B.A dhe ortakë N.A dhe B.A me 50% të kapitalit secili.
- ✓ Konstatohet se: Automjeti me targë AA***SV është përfituar nga subjekti me Kontratë Dhurimi nga vëllai i tij në vitin 2022.

Hetimi administrativ:

- DPSHTRR me shkresën nr.*** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Arben Alika ka aktualisht të regjistruar mjetin me targë AA*** SV. Bashkëlidhur:
- Kontratë Dhurimi, dt. 15.06.2022. Dhurues B.A dhe pranues i dhurimit Arben Alika. Dhuruesi B.A , deklaron se i dhuron vëllait Arben Alika, automjetin e tij Mazda, me targa AA***SV, me vlerë tregu 3.000 euro.
- Kontratë blerje automjeti nr. *** rep, nr. ***kol, dt. 26.08.2017. Automjeti Mazda në shumën 5.000 euro. Palë blerëse B.A.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

Pasuri nr.2.

- ❖ **Apartament banimi** me sip.79.64 m2 adresa Rr. "****" banesa nr. *** (blerë nga Enti i Banesave) nr. rep. ***, nr.*** kol, dt. 12.09.2013, në vlerën 15.314 lekë. Zotëron 33%.
- ❖ **Truall 378,4 m2** (certifikatë regjistrim pasurie datë 10.02.2022), (VKM nr. 827, dt. 30.09.2020), Vlera 28.300 lekë. Zotëron 1/3. Bashkëlidhur deklaratës:
 - Praktika e legalizimit

Hetimi administrativ:

- ASHK, Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr.*** prot., datë 24.08.2023, konfirmon se Arben Alika,, figuron vetdeklarues me nr. *** prot, dt. 13.11.2006, Njësia nr.***, Tiranë. , (subjekti e ka emrin Arben). Objekt i ndërtuar para 1991, nr.*** prot, dt. 03.03.2021, Tirana Jug kaluar me deklaratë noteriale në emrat Arben Alika, T.A, I.A.
- ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr.*** prot, datë 30.08.2023, konfirmon se A.A, figuron vetdeklarues me nr.*** prot, dt. 13.11.2006, për objektin e ndodhur në Njësine Administrative nr.***. Bashkëlidhur:
 - Formular i vetdeklarimit për legalizimin e objektit shtëpi banimi 1 kat + 1 kat dyqan, në adresën e truallit të ndërtimit "****" (ish Reparti), ndërtuar në vitin 1998. Sipërfaqja e zënë 350 m2 dhe Sip. ndërtimi 102 m2, në emër të Arben Alika, dt. 13.11.2006. Certifikata e përbërjes familjare me kryefamiljar Arben Alika, T.A, I.A, T.A + foto të objektit 1 kat + objektit dyqan. Arben Alika, vetdeklarues me nr. ***, dt. 03.03.2021 ”Për kalimin e pronësisë së sipërfaqes oborr në përdorim
 - Me urdhërin nr.***, dt. 11.05.2021 është vijuar me ndryshimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, ku referuar Deklaratës Noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 10.05.2021, ka kaluar nga A A në Arben Alika, T.A , I.A , më tej është vijuar me emetimin e Vendimit nr. ***, dt. 18.5.2021, ”Për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të oborrit në përdorim me sipërfaqe truall funksional 298,4 m2. Bashkëlidhur: Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë ***, vol. ***, fq. ***, ZK.***, apartament me Sip. *** m2, në bashkëpronësi të Arben Alika,, I.A dhe T.A , me 1/3 pjesë secili, lëshuar në dt. 12.10.2013.
 - Deklaratë Noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 10.05.2021, ku Arben Alika, dhe T.A
 - , kanë deklaruar se në aplikimin për legalizim me nr. ***, dt. 03.03.2021 në lidhje me kalimin e pronësisë së oborrit në përdorim të ndodhur në Tiranë në Njësine nr.*** në rrugën “****” duan të përfshijnë edhe fëmijën e tyre I.A dhe certifikimi i oborrit në përdorim të emetohet me 3 emra.
 - Kontratë Shitje Përfundimtare nr. *** rep, nr. *** kol., dt. 12.09.2013. Palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse Arben Alika, T.A dhe I.A . Objekti i kontratës është shitja e një ambienti banimi në bashkëpronësi të pandarë, me Sip. 79.64 m2. Çmimi total i privatizimit të ambientit të banimit e llogaritur sipas Formularit nr. 2 (bashkëlidhur kontratës), është 1.515.182 lekë. Vlera e detyrimit që përfitohet falas, mbështetur në VKM, nr.***, dt. 15.05.2013, është 1.499.868 lekë dhe vlera e detyrimit financiar të mbetur për t 'u paguar nga blerësi është 15.314 lekë, shumë e paguar nga blerësi pranë Credins bank. Pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme me nr. pasurie ***, dt. 18.01.2012. Adresa e pasurisë: ambient banimi nr. 2, lagja "****" ish reparti Ushtarak nr.***, godina nr. ***, qyteti Tiranë.
 - Akt Evidentimi nr. ***, dt. 12.05.2021, për gjendjen ndërtimore në terren, të ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr.*** prot., dt. 03.03.2021, në Rr.

"****", sipërfaqja e parcelës ndërtimore 298,4 m2. Planimetria e objektit për legalizim + objekt i vogël, me shënimin "Dikur ka qenë dyqan ", tani është bosh, nuk e do për legalizim".

- Foto të objektit, shtëpi banimi 1 kat (14 copë)+ genplan.
- Vendim i ASHK, Drejtoria Tirana Jug, nr. ****, dt. 18.05.2021, për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të oborrit në përdorim. Ndër të tjera theksohet se: *Nëpërmjet Urdhrit ****, dt. 11.05.2021 është bërë ndryshimi dhe përfshirja në bazën dixhitale të dhënave, të gjeneraliteteve të poseduesit të ndërtimit informal nga A.A në Arben Alika, T.A dhe I.A , nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. **** rep, nr. **** kol, dt. 10.05.2021. Subjekti posedon certifikate pronësie për apartamentin nr. Pasurie ****, vol. ****, fa. ****, ZK.****, me sip.79.64, në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A , trualli ku ndodhet ky objekt është me nr. pasurie ****, vol. ****, fq. ****, ZK.****, me pronar "Shtet" dhe nr. pasurie ****, vol. ****, fq.****, ZK. ****, me pronar "shtet". Në përfundim ASHK Tirana Jug vendosi: Pranimin e kërkesës për miratimin e dokumentit të pronësisë së oborrit në përdorim, në Zonën Kadastrale ****, në emër të subjektit Arben Alika,, T.A dhe I.A, me të dhënat, sipërfaqe trualli 298,4 m2. Përsa i përket pasurive të regjistruara, figurojnë pasuritë:*

- 1- Nr.****, vol.****, fq. ****, ZK.**** (mbyllur), e llojit apartament në pronësi të Arben Alika, T.A dhe I.A , përfituar me Kontrate Shitje. Bashkëlidhur:
 - Kartela e Pasurisë së paluajtshme nr. pasurie ****, Zk.****, vol. ****, fq.****, apartament me sip.79.64 m2, në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A, regjistruar në dt. 12.10.2013, përfituar me K. Sh. Vlera e paguar 1.515.182 lekë.
 - Kontratë Shitje Përfundimtare nr.**** rep, nr. **** kol, dt. 12.09.2013, me Entin e Banesave, për pasurinë me nr. ****, ZK. ****, me sip.79.64 m2, ndodhur në ****, Tiranë. Çmimi total i privatizimit është vendosur 1.515.182 lekë. Vlera e detyrimit që përfitohet falas është 1.499.868 lekë dhe vlera e detyrimit që mbetet për tu paguar nga blerësi është 15.314 lekë.
 - Vërtetim nga dokumenti hipotekor, nr. ****, dt. 26.12.2011, në emër të Entit të Banesave me nr. pasurie ****, ZK.****, apartament me sip.79.64 m2, ndodhur në lagjen "****" Tiranë.
- 2- Pasuria nr. ****, vol. ****, fq.****, ZK.**** (mbyllur), e llojit "truall" me sip. 187,4 m2, në pronësi të Arben Alika, T.A dhe I.A .
- 3- Pasuria nr. ****, vol.****, fq. ****, ZK.**** (mbyllur), lloji "truall" me sip.111 m2, në pronësi të Arben Alika, T.A dhe I.A . Bashkëlidhur:
 - Certifikatë regjistrimi pronësie për pasurinë ****, ZK.****, truall me sip. 187.4 m2, në emër të Arben Alika, I.A dhe T.A , me pjesë takuese 1/3 secili.
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme, truall me sip. 187.4 m2, nr. pasurie **** ZK. ****, në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A , regjistruar në dt. 27.9.2021.
 - Certifikatë regjistrimi pronësie, për pasurinë nr.****, ZK.****, e llojit truall, me sip.111 m2, në emër të I.A , T.A dhe A.A, me pjesë takuese 1/3 secili, në adresën "Rr. ****".
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë truall, me sip.111 m2, nr. pasurie ****, ZK.****, në emër të Arben Alika,, T.A dhe I.A , regjistruar në dt.27.09.2021.

Pasuritë e sipërcituara janë mbyllur dhe vijojnë në pasurinë nr.****, vol. ****, fq.****, ZK.****, e llojit "truall" me sip. 378.04 m2, në pronësi të Arben Alika, T.A dhe I.A . Bashkëlidhur;

- Certifikatë regjistrimi pronësie, për pasurinë nr. **** ZK.****, e llojit truall me sip.378.04 m2, nga e cila truall, me sip. 378.4 m2 dhe ndërtesë me sip.79.64 m2, në emër të I.A , T.A dhe A.A, me pjesë takuese 1/3 secili.

- Kartela e pasurisë se paluajtshme nr. ***, ZK.***, e llojit truall me sip. 378.4 m2 dhe ndërtesë 79.64 m2, në emër të Arben Alike, T.A dhe I.A , regjistruar më dt.10.02.2022.
- Kartela e Pasurisë se paluajtshme nr.***, vol.***, fq.***, ZK.***, truall me sip.378.04 m2, nga e cila ndërtesë me sip. 79.64 m2, në emër të Arben Alike, T.A dhe I.A , me përshkrimin e veçantë "Gjeneruar nga bashkimi i pasurive vol. ***, fq.***; vol. ***, fq. ***1; vol.***, fq. ***. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë nr. ***, vol.***, fq.***, me shënimin "mbyllur"; kartela e pasurisë nr.***, vol. ***, fq. ***, me shënimin "mbyllur"; kartela e pasurisë nr.***, vol. ***, fq.***, me shënimin "mbyllur".

 Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se apartamenti/banesa është përfituar në bazë të vendimit nr. ***, dt. 29.04.2011. Për këtë banesë ka paguar vetëm një shumë prej 50.0000 lekë, mesa mban mend, ndërsa pjesa tjetër është paguar nga Enti i Banesave. Ka deklaruar se në vitin 2006, ka bërë kërkesë për legalizim për të gjithë objektin dhe për tokën që disponojnë sot. Në kërkesë ka qenë përfshirë edhe një ndërtim i vogël, që do përshtatej për dyqan/magazinë. Dyqani/magazina është ndërtuar në vitin 1998 dhe ndodhet në oborrin përpara shtëpisë. Vlera e ndërtimit ka qenë rreth 210.000 lekë, por për ndërtimin e saj nuk zotëron asnjë faturë. Burimi ka qenë nga të ardhurat dhe kursimet familjare. Ka sqaruar se shuma e investimit të shënuar nga ALUIZNI, në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukture për objektet informale, është si rezultat i llogarive të bëra nga ana e tyre dhe nuk është shuma e investuar nga ana e tij, për ndërtimin e këtij aseti. Me anë të kësaj kërkesë të bërë për legalizim të objektit dhe dyqanit/magazinës, nuk është legalizuar asgjë, pra as banesa, as dyqani dhe as trualli. Por ky proces u bë në vitin 2020, me VKM 827, dt. 30.09.2020. Pra i gjithë procesi i konfirmuar nga ASHK ka të bëjë me banesën e përfituar nga Enti i Banesave dhe regjistrimit të dy sipërfaqeve të truallit që ndodhen përpara dhe pas kësaj banese. Për truallin nuk është paguar asgjë përveç pagesave të kryera në ASHK për tarifën e aplikimit. Trualli me sip. 378.4 m2, nga e cila banesë me sip.79.64m2, është përfituar pas bashkimit të gjithë pasurisë në një certifikatë të vetme dhe konkretisht shtëpisë me sip. 79.64 m2 + truallit me sip. 187.4 m2+ truallit me sip.111 m2. Në lidhje me rikonstrukcionin e banesës ka deklaruar se është investuar për rikonstrukcionin e çatisë në vitin 2009 dhe shuma e investuar ka qenë në një vlerë të përafërt rreth 500.000 lekë, por nuk ka mbajtur as fatura, as situacion apo preventiv punimesh. Burimi i kësaj shumë ka qenë nga të ardhurat e pagave. Presa i përket mobilimit të banesës ka deklaruar se është bërë ndër vite dhe konkretisht; rreth vitit 2008 janë blerë pajisje shtëpie, në shumën totale rreth 557.000 lekë. Në vitin 2015 është blerë dhoma e fëmijëve, në shumën 120.000 lekë, si dhe është bërë shtrimi me pllaka e shtëpisë, ashtu edhe i oborrit me beton, rreth 450.000 lekë (totale 570.000 lekë). Në vitin 2016 është blerë një sobë peleti rreth 120.000 lekë dhe kondicioner rreth 80.000 lekë (totale 200.000 lekë). Për të gjitha këto shpenzime nuk disponon fatura. Nuk mendon se ka bërë shpenzime të tjera për mobilimin dhe rregullimin e banesës.
Bashkëlidhur:

- Vendim nr. 327, dt. 29.04.2011, për kalimin në fond banesash të ish-objekteve të dala nga ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme (Reparti Ushtarak nr. ***) Tiranë, me qëllim privatizimi, në emër të banorëve, nga Enti i Banesave, ku është vendosur: "Objektet e repartit ushtarak nr. ***, të ndodhur në "****", Tiranë, miratuar me vendimin nr. 255, dt. 03.09.1994. të Ministrisë së Rendit Publik, si objekte të lira nga ristrukturimi, kalojnë në fond banesash për Entin Kombëtar të Banesave. Pas kalimit të këtyre objekteve në fond banesash dhe regjistrimit të tyre në ZVRPP-në Tiranë, Enti i Banesave ngarkohet të lidhë kontratat e privatizimit me

banorët e pastrehë, sipas listave emërore të familjeve. (Në listën emërore të banorëve është edhe Arben Alika).

- *Njoftim nr. *** prot, dt. 15.03.2012, nga Enti i Banesave, drejtuar Z. Arben Alika, për pajisjen e Entit të Banesave me certifikate pronësie, për objektin ku ai aktualisht banon dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për të bërë të mundur lidhjen e kontratës së privatizimit.*
- *Certifikate pronësie për pasurinë apartament me sip. 79.64 m2, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ZK. ***, ne adresën "Rr. ****" Tiranë, në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A, lëshuar ne dt. 12.10.2013. Bashkëlidhur Kartela e Pasurisë së Paluajtshme, ku konfirmohet regjistrimi i pasurisë ne dt. 12.10.2013, me K. Sh, në verën 1.515.182 lekë.*
- *Kontratë përfundimtare shitje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 12.09.2013, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse Arben Alika, T.A dhe I.A. Ambient banimi në bashkëpronësi të pandarë me sip. 79.64 m2. Vlera e privatizimit është caktuar 1.515.182 lekë. Vera e detyrimit që përfitohet falas, mbështetur në VKM nr. 414, dt. 15.05.2013, është 1.499.868 lekë. Vlera e detyrimit financiar për t'u paguar nga blerësi, mbështetur në VKM nr. 414, dt. 15.05.2013, është 15.314 lekë, që pasqyron shpenzimet operationale (4%), si dhe shpenzimet hipotekore. Pasuria është regjistruar në ZRPP Tiranë në emër te shitësit, me nr. pasurie ***, dt. 18.01.2012, në adresën lagjja "****", ish reparti ushtarak nr.***, godina nr.***, Tiranë. Bashkëlidhur; Vërtetim nga dokumentet hipotekore, ku konfirmohet se në regjistrin hipotekor, me nr. ***, dt. 26.2.2011, figuron e regjistruar në pronësinë e Entit të Banesave, pasuria me nr. ***, ZK.***, apartament me sip.79.64 m2. Harta treguese e regjistrimit. Formulari nr.1, i llogaritjeve të treguesve të shitjes së banesës: Ish Reparti Ushtarak, godina nr,***, Tiranë. Formulari nr. 2, për llogaritjen e çmimit të apartamentit.*
- *Certifikatë familjare në emër të Arben Alika.*
- *Planimetria e apartamentit.*
- *Plani i Vendosjes së Apartamentit.*
- *Vetë deklaram për legalizimin e objektit shtëpi banimi 1 kat + 1 kat dyqan, në adresën"****" (ish Reparti), ndërtuar në vitin 1998, në emër të Arben Alika, e vitit 2006. Bashkëlidhur Formulari i pagesës se taksës së ndikimit në infrastrukture për objektet informale. Konfirmohet numri i vetdeklarimit *** dt. 13.11.2006. Vera e investimit 1.889.811 lekë dhe vlera e taksës 9.449 lekë.*
- *Vendimin nr. ***, dt. 18.05.2021, të ASHK, Tirana Jug, për miratimin e kërkesës për kalimin e pronësisë se oborrit ne përdorim, ku theksohet se ne zbatim te Vendimit nr. 827, dt. 30.09.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave të hollësisshme për miratimin e dokumentit të pronësisë së objekteve pa titull pronësie dhe oborreve në përdorim", u mor në shqyrtim kërkesa me nr. *** prot., dt. 03.03.2021, për kalimin ne pronësi të oborrit në përdorim, me subjekt kërkuës A.A. Në përfundim të verifikimeve te gjendjes ndërtimore në terren, si dhe gjendjes juridike te pasurisë së pretenduar është vendosur; "Pranimi i kërkesës për miratimin e dokumentit të pronësisë së oborrit në përdorim, ne ZK.***, në emër të Arben Alika T.A dhe I.A, me sipërfaqe 298.4m2". Bashkëlidhur:*
 - a. *Genplan.*
 - b. *Kartela e pasurisë se paluajtshme, nr. *** ZK.***, e llojit truall, me sip. 187.7 m2, në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A , regjistruar në dt. 27.09.2021, me Vendim për Kalimin e Pronësisë nga ASHK, nr. ***, dt. 18.05.2021.*
 - c. *Kartela e pasurisë se paluajtshme nr. ***, ZK.***, e llojit truall, me sip. 187.7 m2 me adresë "Rr. ****", në emër të Arben Alika, T.A dhe I.A, regjistruar në dt. 27.09.2021, me Vendim për Kalimin e Pronësisë nga ASHK, nr. *** dt. 18.5.2021.*

- d. Kartela e pasurisë së paluajtshme, nr. ***, ZK.***, e llojit truall, me sip. 111 m2, me adresë Rr. "****" në emër të Arben Alike,, T.A dhe I.A , regjistruar në dt. 27.09.2021, me Vendim për Kalimin e Pronësisë nga ASHK, nr. ***, dt. 18.05.2021.
- e. Kërkesë për bashkim pasurish dt. 19.01.2022, drejtuar ASHK, ku nga Arben Alike është kërkuar bashkimi i pasurive të ndodhura në ZK.***, me nr.; *** dhe nr. ***, në një pasuri të vetme.
- f. Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. *** ZK. ***, e llojit truall, me sip. 378.4 m2, nga e cila ndërtesë 79.64 m2, në emër të Arben Alike, T.A dhe I.A , regjistruar në dt. 10.02.2022.
- g. Certifikatë regjistrimi pronësie, për pasurinë nr. ***, ZK.*** e llojit truall, me sip. 378.4 m2, nga e cila ndërtesë me sip. 79.64 m2, në emër të Arben Alike, me pjesë takuese 1/3. Bashkëlidhur; Fragment i hartës kadastrale.
- h. Kërkesat në ASHK, për informacionin zyrtar mbi pasuritë, për regjistrimin e pasurive si dhe lëshimin e certifikatave të pronësive të datave 23.11.2018; 30.07.2021; 08.09.2021 dhe 19.01.2022, si dhe faturave të pagesave të tarifave të aplikimit në shumën rreth 28.700 lekë.
- i. Foto të objektit shtëpi + dyqan/magazinë, si dhe të mobilimit të brendshëm të banesës.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Pasuria me nr.***, ZK.***, e llojit truall me sip.378.04 m2, nga e cila truall me sip.378.4 m2 dhe ndërtesë me sip.79.64 m2, në b/pronësi të subjektit, b/shortes dhe djalit I.A , është përfituar në bazë të:

1. Vendimit nr. 255, dt. 03.09.1994, të Ministrisë së Rendit Publik, për miratimin e objekteve të Repartit Ushtarak nr. ***, të ndodhur në "****", si objekte të lira nga ristrukturimi, kalojnë në fond banesash për Entin Kombëtar të Banesave.
2. Vendimit nr. 327, dt. 29.04.2011, për kalimin në fond banesash të ish-objekteve të dala nga ristrukturimi i Ministrisë së Brendshme (Reparti Ushtarak nr. ***) Tiranë, me qëllim privatizimi, në emër të banorëve, nga Enti i Banesave.
3. Kontratës Përfundimtare te shitjes me Entin Kombëtar te Banesave nr. *** Rep, nr.*** Kol, dt. 12.09.2013.
4. Vendimit nr. 157, dt. 18.05.2021, të ASHK, Tirana Jug, për miratimin e kërkesës për kalimin e pronësisë së oborrit në përdorim.
5. Kërkesës për bashkim të pasurive dt. 19.01.2022.

Shuma e paguar nga subjekti, pas uljeve të përfituara nga Enti i Banesave, është 15.314 lekë.

Subjekti fillimisht ka blerë apartamentin me sip. 79.64 m2, me adresë "****", Tiranë, nga Enti i Banesave, me vendim të Ministrisë së Rendit Publik, në v. 1994. Më pas ka ndërtuar, në v. 1998, objekt/dyqan, për te cilin ka shpenzuar rreth 210.000 lekë dhe ka aplikuar për legalizimin e tij në v. 2006. Në v. 2021 ka kërkuar kalimin e pronësisë se oborrit në përdorim dhe heqjen dorë nga legalizimi i dyqanit.

- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me pasurinë truall me sip. 378.04 m2 dhe ndërtesë me sip.79.64 m2, në Rr. "****" në Tiranë dhe mënyrën e përfitimit të saj gjatë periudhës 1991 - 2022.**
- ✓ **ASHK konfirmon b/pronësinë e subjektit dhe personave të lidhur në këtë pasuri.**

- ✓ **Shuma e shpenzuar për ndërtim dyqani në v. 1998 është deklaruar rreth 210.000 lekë, si dhe shpenzime për arredim dhe rikonstruksion banese gjatë periudhës 2008 - 2016, rreth 1.827.000 lekë.**
- **Gjendje cash 150.000 lekë, nga kursimet. Zotëron 100%**
- ✓ **Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash të deklaruar.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Sipas listpagesës mujore të pagave prill 2023 (Arben Alika,), shuma 112.045 lekë.
- Paga mujore baze 87.203 lekë (T.A).
- Paga mujore 59.460 lekë. (T.A.).
- Bashkëlidhur deklaratës:
- Listpagesa mujore e pagave në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë. Konfirmohet paga neto mujore për muajin prill 2023, për Arben Alika, në shumën 112.045 lekë.
- Vërtetim page dt. 14.01.2023, nga *** shpk, konfirmohet paga mujore për T.A , në shumën 87.203 lekë.
- Vërtetim nga DRT Tiranë, printuar nga E-Albania, për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, nr. ***, dt.15.04.2023. Konfirmohet derdhja e kontributeve për T.A, për periudhën janar 2022 - mars 2023.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të Arben Alika, për periudhën 2005 - 2015. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën prill 2005 - qershor 2009, në shumën totale 1.763.825 lekë.
- ✚ **BKT** me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon Llogari page në emër të T.A me balancë në dt. 28.4.2023, shumën -67.579 lekë. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën qershor 2020 - mars 2023, në shumën totale 1.288.865 lekë.
- ✚ **Intesa SanPaolo Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon llogari page në emër të T.A , për periudhën 13.12.2007 - 26.06.2018. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën nëntor 2007 - prill 2017, në shumën totale 3.758.338 lekë.
Konfirmon Llogari page në emër të T.A, për periudhën 19.05.2016 - 28.03.2017. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën prill - maj 2016, në shumën 22.247 lekë.
- ✚ **Tirana Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon llogari page në emër të A.A, për periudhën gusht 2010 - 18.04.2018. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën korrik 2010 - shkurt 2012, në shumën totale 957.175 lekë.
- ✚ **Credins Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2023, konfirmon llogari page në emër të A.A, për periudhën dhjetor 2007 - prill 2023. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën dhjetor 2007 - qershor 2010, në shumën totale 1.410.737 lekë dhe për periudhën shtator 2013 - mars 2023, në shumën totale 9.613.286 lekë. Balanca e Llogarisë në dt. 28.04.2023, në shumën 749 lekë. (Sipas statementit në dt.06.12.2013, rezulton kreditim i shumës 4.390.913 lekë nga

*** Grup, paga të prapambetura janar - tetor 2013 dhe në dt. 30.12.2013, shuma 1.340.000 lekë, paga të prapambetura nëntor 2013). *Konfirmon të ardhura nga paga për T.A, për periudhën nëntor 2018 - shtator 2019, në shumën 378.042 lekë. Mbyllur llogaria në vitin 2020.*

✚ **OTP Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 28.07.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të T.A , për periudhën 09.06.2017 - 28.04.2023. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën maj 2017 - mars 2023, në shumën totale 4.016.295 lekë.

✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Arben Alike, nga Bashkia Tiranë, për periudhën janar 2012 - maj 2012, nga *** shpk. për periudhën korrik 2012 - shkurt 2013; nga *** Grup për periudhën nëntor 2012 - qershor 2014 dhe nga Drejtoria e Policisë për periudhën korrik 2014 - qershor 2023. *Konfirmon kontributet e derdhura për T.A nga *** për periudhën janar 2012 - mars 2012, nga *** për periudhën prill 2012 - qershor 2023.*

✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. V-Prot., date 09.08.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.

→ *Në proces-verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se marrëdhëniet e punës i ka filluar, në polici, në dt. 01.08.1990 deri në vitin 16.12.2006. Është larguar për shkurtim të funksionit organik në dt. 16.12.2006 dhe ka punuar në Bashkinë Tiranë IMT, nga nëntor - dhjetor 2007 deri në janar të vitit 2012. Për disa muaj ka punuar tek biznesi i vëllezërve të tij dhe rreth qershorit 2012 ka filluar pranë *** deri në dt. 11.06.2014. Në dt. 11.06.2014 ka rifilluar në Policinë e Shtetit në funksione të ndryshme deri më sot.*

Bashkëshortja ka filluar marrëdhëniet e punës nga viti 2007 e në vazhdim dhe vajza T.A në prill 2016 e në vazhdim. Ka dorëzuar:

- Fletë nga regjistri i Drejtorisë se Policisë të Qarkut Gjirokastrë, ku pasqyrohet historiku i punonjësit të Policisë, se ku ka studiuar dhe punuar. Konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës në dt. 01.08.1990 deri në 16.12.2006 dhe nga 11.06.2014 e në vazhdim; Të ardhurat nga paga për periudhën 01.08.1990 - 31.12.1994, në shumën rreth 78.247 lekë (llogaritur në bazë të fletës së regjistrimit me përfaqësi) Vërtetim nr. *** prot, dt. 24.10.2023, nga Ministria e Brendshme. Konfirmohen të ardhurat nga paga e Arben Alike,, për periudhën 01.01.1994 - 01.07.2001, në shumën totale rreth 1.030.949 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare për Arben Alike,, për periudhën 01.07.2002 - 01.09.2004. Konfirmohen të ardhurat nga paga mbi të cilën është derdhur kontributi, në shumën 1.122.298 lekë.
- Vërtetim nr.*** prot, dt. 20.10.2023, nga Drejtoria Vendore Tiranë. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Arben Alike, për periudhën 01.09.2004 - 15.04.2005, në shumën neto 253.203 lekë. Shpërblime + leje vetore në shumën 70.862 lekë.
- Nxjerrje llogari nga Raiffeisen Bank, në emër të Arben Alike,, për periudhën 17.02.2005 - 18.04.2018. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën prill 2002 - qershor 2009, në shumën 1.763.725 lekë. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Arben Alike, për periudhën

- 01.01.2003- 31.12.2013. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën dhjetor 2007 - qershor 2010, në shumën 1.410.737 lekë dhe shtator 2013 - nëntor 2013, në shumën totale 135.930 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., dt. 05.10.2023, nga *** shpk. Konfirmohen të ardhurat nga paga për Arben Alika, për periudhën 09.11.2012 - 25.06.2014, në shumën totale 769.074 lekë. Të ardhurat për periudhën nëntor 2012 - gusht 2013, në shumën 303.232 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të Arben Alika,, për periudhën 01.01.2014 - 24.10.2023. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën dhjetor 2013 - mars 2023, në shumën 9.477.356 lekë.
 - Të dhënat e llogarisë në emër të Arben Alika, në Credins Bank. Konfirmohet çelja e llogarisë në dt. 24.12.2007. *Bashkëlidhur konfirmim nga Credins Bank, nr. *** prot, dt. 16.10.2023. Në lidhje me shumat e kredituara në llogari nga *** Group, në datën 06.12.2013, shuma 4.390.913 lekë dhe në dt. 30.12.2013, shuma 1.340.000 lekë ka deklaruar se ka qenë drejtues teknik dhe administrator i shoqërisë *** Group dhe këto shuma janë lëvruar në llogarinë e tij, për llogari të shoqërisë, për efekt shpejtësie. Nuk kanë qenë të ardhura për të, por për pagesa të prapambetura për punonjësit. Ka dorëzuar;*
 - Vërtetim nga *** Group, nr. *** prot., dt. 26.10.2023, ku konfirmohet se Arben Alika, administrator i shoqërisë "****" nga dt. 09.11.2012 deri në 25.06.2014, është paguar si pagator për pagat e prapambetura të punonjësve të "****" për periudhën janar - nëntor 2013, në vlerat respektive 4.390.913 lekë, ne dt. 06.12.2013 dhe 1.340.000 lekë, ne dt. 30.12.2013, si pas listë pagesave bashkëlidhur.
 - Listë pagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të subjektit ***, për vitin 2013 + pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2013.
 - Certifikatë regjistrimi për personin e tatueshëm *** Group shpk, me NIPT L223***R, dt. 09.11.2012. Bashkëlidhur Licenca nga QKL dhe Vendimi nr. ***, nga DPPSH, për miratimin e dhënien e licencës titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik Arben Alika, për SHRSF "****".
 - Certifikatë për titullar subjektit, (në fushën e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes e sigurisë fizike) nr. *** prot., dt. 12.02.2013, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për z. Arben Alika.
 - Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank, në emër të T.A. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën nëntor 2007 - prill 2017, në shumën totale 3.758.338 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, në emër të T.A. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën maj 2017 - mars 2023, në shumën totale 4.016.295 lekë.
Vërtetim nr. *** prot., dt. 23.10.2023, nga *** shpk. Konfirmohet se T.A është e punësuar pranë kësaj shoqërie nga data 02.04.2012 dhe aktualisht. Të ardhurat e përfituara nga paga janë në shumën totale 5.939.159 lekë.
Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH, printuar nga E- Albania, dt. 25.10.2023. Konfirmohen kontributet e derdhura për T.A mbi bazën e pagës bruto për periudhën prill 2016- qershor 2016; tetor 2018-shtator 2019; dhe janar 2021-shtator 2023. *Totali i pagesave të kontributeve gjithsej 59.460 lekë.*
Nxjerrje llogarie nga BKT në emër të T.A, ku konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën dhjetor 2022-shtator 2023.
- *Në përfundim, të ardhurat e subjektit nga paga dhe shpërblime, gusht 1990-prill 2023 gjithsej 16.604.000 lekë.*
 - *Të ardhurat neto të bashkëshortes për periudhën nëntor 2007- prill 2023, gjithsej 7.775.000 lekë.*
 - *Të ardhurat neto të vajzës T.A, për periudhën prill 2016- prill 2023, gjithsej 1.689.000 lekë.*

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

→ *fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe te gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.*

Subjekti ka deklaruar:

Shpenzime për vitin e fundit, periudha janar - dhjetor 2022, 29.977 + 64.291 + 27.853 + 44.400 = 166.521 lekë (ujë, drita, internet tel cel).

- FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon kontratë furnizimi me energji elektrike, në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot. Datë 18.08.2023, konfirmon se në emër të Arben Alike, rezulton një kontratë me nr. 022***, për objektin me adresë Rr. "****", me detyrime të pa likuiduara 2.482,2 lekë deri ne datë.04.08.2023.
- 14 Shoqëritë Rajonale te Ujësjiellës - Kanalizime, me shkresat nr. *** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Vodafone Albania sha, me shkresën nr. *** prot, dt. 06.11.2023, konfirmon se në emër të Arben Alike, janë të regjistruar 2 numra celularë me status aktiv dhe një numër me status in aktiv, larguar nga rrjeti i shoqërisë Vodafone, në dt. 04.12.2017. Shuma e paguar për vitin 2022 për të dy numrat në emrin e tij është 21.811 lekë. Në emër të T.A është i regjistruar 1 numër celular me status aktiv dhe një numër me status in aktiv, larguar nga rrjeti i shoqërisë Vodafone në dt. 18.10.2017. Shuma e paguar për vitin 2022, për numrin ne emrin e saj, është 10.085 lekë. Në emër të I.A është i regjistruar një numër celular me status in aktiv, larguar nga rrjeti i shoqërisë Vodafone në dt. 13.03.2014. Gjithashtu konfirmohet se Arben Alike dhe personat e lidhur, nuk kanë kontratë interneti ose fiksi me shoqërinë Vodafone Albania sha.
- One Albania sha, me shkresën nr. *** prot, dt. 26.09.2023, konfirmon se në emër të Arben Alike, figurojnë të regjistruar 2 numra celular dhe një numër fiks One Albania. Totali i pagesave për të tre numrat për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ne shumën totale 25.634 lekë.
- T.A ka të regjistruar 1 numër celular me One Albania dhe shpenzimet për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 është 3.704 lekë.
- I.A po ashtu në One Albania ka një numër të regjistruar dhe totali i pagesave për këtë periudhë është 4.940 lekë.
- T.A, nuk rezulton të ketë numra te regjistruar ne shërbimin e telefonisë mobile, telefonisë fikse/internetit ne rrjetin One Albania.
- Albania Satelitë Communications shpk, me shkresën nr. *** prot., dt.14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Abissnet sha, me shkresën nr. V-Prot, dt. 04.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Digicom sha, me shkresën nr. *** prot, dt. 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.


✚ *Në Proces-Verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se në emrin e tij ka dy numra celulari, b/shortja dhe fëmijët nga 1 numër celulari. Përsa i përket detyrimeve të konfirmuara*

nga UKT, ka sqaruar se për vitin 2022 nuk ka pasur detyrime të papaguara, por ndoshta detyrimi mund të jetë për faturat e fundit të vitit 2023. Ka dorëzuar:

- Kopje të librezës me FSHU në emër të Arben Alike. Konfirmohet pagesa e detyrimeve për vitin 2022, në shumën totale 68.393 lekë.
- Kopje e librezës së pagesave të UKT në emër të Arben Alike, nr. kontrate 022***
Konfirmohen pagesat për vitin 2022, në shumën 30.693 lekë.
- Kopje e librezës së pagesave të internetit në numrin fikse, në emër të Arben Alike.
Konfirmohet se për vitin 2022 është paguar shuma 27.950 lekë.
- Informacion nga Vodafone në lidhje me pagesat e kryera për numrat e celularit në emër të Arben Alike, dhe T.A. Shuma e paguar për vitin 2022 për tre numrat (2 në emër të Arben Alike, dhe 1 në emër të T.A rreth 31.856 lekë.
- o Faturat e pagesave të kryera nga T.A për shoqërinë One Albania për periudhën janar 2022-dhjetor 2022, në shumën 13.011 lekë.

Me e-mailin e datës 07.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- o Faturat e pagesave të kryera nga I.A për shoqërinë One Albania për periudhën janar 2022 dhjetor 2022, në shumën 19.580 lekë. Shpenzimet e deklaruara për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, në total për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë rreth 192.000 lekë.

 Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

- Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka sqaruar se ka deklaruar shumën e shpenzuar gjatë të gjitha udhëtimeve të tij dhe personave të lidhur gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu ka sqaruar se vajza ka udhëtuar në vitin 2022 për në Sarajevë për 9 ditë me programin *** dhe shpenzimet janë përballuar nga ky program.
- Ka dorëzuar Raportet nga Sistemi Tims për të gjitha hyrje daljet e tij dhe të personave të lidhur.
- Raport nga sistemi TIMS, për dt. 18.10.2023. Konfirmohet një hyrje/dalje nga pika
- Me e-mailin e datës 10.11.2023, subjekti ka paraqitur sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se udhëtimi i vajzës jashtë shtetit i datës 13.05.2022 dhe kthimi në dt. 22.05.2022 nga pika kufitare Hani Hotit ka qenë me programin ERASMUS, ku udhëtimi dhe gjithë shpenzimet janë hequr nga programi.
- Në lidhje me udhëtimin e datës 09.08.2022 deri në dt. 24.08.2022, vajza ka shkuar në Itali, Santo-Stefano Al Mare, Liguria, tek motra e tij E.D, rezidente aty me familje me kthim nga Nice-France, pasi është aeroporti më afër se Xhenova apo Milano. Shpenzimet dhe akomodimi (fjetja) janë kryer nga motra e tij.

Me e-mailin e datës 13.11.2023, subjekti ka paraqitur;

- Vërtetim pjesëmarrje "Youthpass" nga projekti Erasmus + në emër të T.A, ku konfirmohet pjesëmarrja në projektin e zhvilluar në Sarajevo, Bosia & Hercegovina për periudhën 13.05.2022 - 22.05.2022.
- Rezervim bilete fluturimi në emër të T.A për datat 09.08.2022 - 23.08.2022, me intinerar Tirana - Malpensa dhe Nice - Tirana, në shumën totale 170 euro.

✚ Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 700 euro. konvertuar rreth 78.000 lekë.

- Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
- I.A (UMB Tiranë dega Menaxhim Agrobiznes): Bachelor (2012-2015) në shumën 120.000 lekë. Master profesional (2015-2017) në shumën 110.000 lekë.
- T.A (Universiteti i Tiranës, Fakulteti Shkencave Sociale, Pune Sociale): Bachelor (2015 - 2018) në shumën 120.000 lekë; Master shkencor (2018 - 2020), në shumën 115.000 lekë.

Në proces - verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Vërtetim nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, nr. *** prot, dt. 23.10.2023. Konfirmohen pagesat e kryera nga I.A për periudhën 18.01.2012 - 30.01.2017, në shumën totale 173.061 lekë.
- Diplomë Master Profesional në emër të I.A , dt. 01.11.2017, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Diplomë Bachelor në emër të I.A nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, lëshuar në dt. 30.07.2015.
- Diplomë e Maturës shtetërore në emër të I.A nga Ministria e Arsimit.
- Dëftesë Lirimi e shkollës 9 vjeçare "****" në emër të I.A
- Vërtetim nr.*** prot, dt.27.10.2023, nga Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë, ku konfirmohen pagesat e kryera nga T.A, për ciklin e studimeve Bachelor dhe Master për periudhën 2016 - 2020, në shumën totale 232.500 lekë.
- Diplomë Master i Shkencave, në emër të T.A, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale.
- Diplomë Bachelor në Punë Sociale, në emër të T.A, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Shkencave Sociale.
- Diplome e Maturës shtetërore në emër të T.A, nga gjimnazi "****".
- Dëftesë Lirimi e shkollës 9-Vjeçare "****" në emër të T.A.
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara dhe te dokumentuara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës 2012 - 2020, rezultojnë në total rreth 462.000 lekë.

DEKLARIMI I B/SHORTES - T. ALIKA.

DEKLARIMI I PASURIVE


- Apartament banimi me sip.79.64 m2 adresa Rr. "****" banesa nr. *** (blerë nga Enti i Banesave) nr. rep.***, nr. *** kol., dt. 12.09.2013, në vlerën 15.314 lekë. Zotëron 33%. Trajtuar më sipër.
- Volkswagen Polo, vit prodhimi 2009 (blerë nga kursime dhe të ardhurat familjare dhe shitje e mjetit mercedez). Faturë tatimore shitje nr.***, datë 06.09.2017, në shumën 5.040 euro. Zotëron 100%
 - DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se T.A ka të regjistruar mjetin me targë AA***SJ. Bashkëlidhur;

- Faturë Tatimore shitje nr.***, dt.06.09.2017, me palë blerëse T.A, për automjetin VW Polo, me nr. Shasie WVWZZZ9NZ9Y2***, në shumën 5.040 euro.

Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Fature Tatimore shitje nr.***, dt.06.09.2017, me pale blerëse T.A , për automjetin VW Polo, me nr. Shasie WVWZZZ9NZ9Y2***, në shumën 5.040 euro. Certifikatë Pronësie automjeti, me targë AA***SJ, me nr. shasie WVWZZZ9NZ9Y2***, në emër të T.A .
- Kontratë Shitje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol., dt. 13.11.2017, me palë shitëse T.A. Automjet Daimlerchrysler A 170 CDI, nr. shasie WDD1680091K0***, me targë AA*** NT, në shumën 3.100 euro.
- Kontratë blerje automjeti dt. 21.03.2016, Mercedes A170 CDI, nr. shasie WDD1680091K***, në shumën 800 Euro, me palë blerëse T.A .

*Me e-mailin e datës 13.11.2023, subjekti ka paraqitur sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit me targë AA***SJ kanë qenë nga kursimet familjare.*

 *Konstatohet se: Automjeti me targë AA*** SJ, në pronësi të b/shortes, është blerë në vitin 2017, në shumën 5.040 euro, me burim të ardhurat familjare.*

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

- Truall: 378.4 m2 (certifikatë regjistrimi pasurie datë 10.02.2022), (VKM nr.827, dt.30.09.2020), Vlera 28.300 lekë. Zotëron 1/3. Trajtuar më sipër.
 - OTP Bank, llogari me balancë 847.627,43 lekë. Zotëron 100%.
 - OTP Bank, me shkresën nr. *** prot., date 28.07.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të T.A , me balance në dt. 28.04.2023, në shumën 817.627 lekë.
- ✓ **U konstatua se llogaria është krijuar gjatë periudhës 2017-2023 me burim kreditimet e pagës dhe konfirmohet deklarimi me dokumentacionin.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga kontrata e shitjes së automjetit me nr. rep.***, nr. kol ***, dt. 13.11.2017, mercedes A 170 CDI, me targë AA***NT, në shumën 3.100 Euro.
- Të ardhura nga paga mujore bazë 87.203 lekë.
- Blerja /shitja e automjetit, si dhe te ardhurat nga paga, trajtuar më sipër.

DEKLARIMI I DJALIT - I. ALIKA.

DEKLARIMI I PASURIVE

- Apartament banimi me sip.79.64 m2, adresa Rr. "****" banesa nr. ***. Blere nga Enti i Banesave nr. rep. ***, nr. *** kol., dt. 12.09.2013, në shumën 15.314 lekë. Zotëron 33%. Trajtuar më sipër.
- Truall 378.4 m2 (certifikatë regjistrimi pasurie dt. 10.02.2022) VKM nr. 827, dt. 30.09.2020, në shumën 28.300 lekë. Zotëron 1/3.Trajtuar më sipër.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga mbi të cilat janë derdhur kontributet, 63.000 lekë. Bashkëlidhur deklaratës:
 - Vërtetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, nr. T0812*** dt. 13.04.2023, nga DRT Tiranë, printuar nga E-Albania. Konfirmohet derdhja e kontributeve për I.A, për periudhën janar 2022 - shkurt 2023.
 - Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon llogari page në emër të I.A, për periudhën 07.08.2015 - 09.12.2021. Konfirmohen të ardhurat nga pagat, për periudhën korrik 2015- shtator 2020 në shumën 3.202.222 lekë. Balanca e llogarisë në dt. 28.04.2023 në shumën 52 lekë.
 - ABI Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon llogari page në emër të I.A, për periudhën 09.11.2020 - 28.04.2023, me balancë në dt. 28.04.2023 në shumën 7 lekë. Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën tetor 2020 - mars 2023, në shumën totale 1.626.020 lekë.
 - ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon kontributet e derdhura për I.A, nga ICTS Albania, për periudhën korrik 2015 - korrik 2017, nga OSHEE për periudhën korrik 2017 - dhjetor 2019, nga OSSH për periudhën janar 2020 - qershor 2023 dhe ESM, për muajin qershor 2023.
 - ISSH, Drejtoria e Arkivit qendror, me shkresën nr. V-Prot., datë 09.08.2023, konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.
- Në Proces-Verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se djali i tij I.A, ka filluar marrëdhëniet e punës në korrik 2015 e në vazhdim. Ka sqaruar se në qershor të vitit 2019 djali është martuar dhe është ndarë nga trangu familjar. Ka paraqitur;
- Vërtetim nga Credins Bank nr.*** prot, dt. 23.10.2023, ku konfirmohet se I.A është klient i bankës me llogari rrjedhëse në lekë, çelur në dt. 08.06.2023, me balance aktuale shumën 573 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të I.A , për periudhën 08.06.2023 - 23.10.2023. Konfirmohet kreditimi i pagës për periudhën qershor 2023 - shtator 2023.
 - Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH, printuar nga E-Albania në dt. 29.10.2023. Konfirmohen kontributet e derdhura për I.A, për periudhën korrik 2015 - shtator 2023.
 - Vërtetim nga OSHEE dt. 17.10.2023. Konfirmohen të ardhurat nga paga për I.A, për periudhën 20.07.2017 - 06.06.2023.
 - Certifikatë martesë dt. 25.10.2023 për I.A, ku konfirmohet lidhja e martesës në dt. 10.06.2019.
- Të ardhurat neto nga paga e djalit I.A, për periudhën korrik 2015 - prill 2023 rezultojnë në shumën rreth 4.828.000 lekë.

DEKLARIMI I VAJZËS - T.ALIKA.
DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Paga mbi të cilën janë derdhur kontributet, 59.460 lekë. Trajtuar me sipër.

Në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar, subjekti Arben Alika, ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon: *Njësia Administrative nr.***, Rr.***, banesa nr.***, Bashkia Tiranë.*

→ Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se djali I.A , jeton në shtëpi me qira në zonën e Astirit. Nuk ka pasuri në emrin e tij as të luajshme as të paluajshme.

→ Me e-mailin e datës 07.11.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Kontratë qira banese dt. 10.05.2023, me qiramarrës I.A , E.A. dhe qiradhënës B.S. Apartament 1+1, rruga "****" Astir, në shumën mujore 300 Euro.
- Depozitim në arkë të shumës 277 euro, nga T.A, dt. 11.07.2023, për B.S., "Pagesë qiraje muaji korrik 2023"

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me banesën marrë me qira nga djali I.A, në maj 2023 si dhe për banesën ku jeton aktualisht.**

➤ Gjithashtu subjekti ka dorëzuar:

- Certifikatë familjare me kryefamiljar Arben Alika, dt. 30.03.2023.
- Kopje ID në emër të Arben Alika.
- Kopje ID në emër të T.A .
- Kopje ID në emër të T.A.
- Certifikatë familjare me kryefamiljar I.A, dt. 13.04.2023.
- Kopje ID në emër të I.A .
- Kopje ID në emër të E A.
- Kopje ID në emër të T.A.

→ Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka dorëzuar;

- Certificate familjare me kryefamiljar Arben Alika, dt. 02.03.2021.
- Kopje pasaporte në emër të Arben Alika.
- Kopje pasaporte në emër të T.A.
- Kopje pasaporte në emër të T.A.
- Certifikatë familjare me kryefamiljar I.A, dt. 17.10.2023.
- Kopje pasaporte në emër të I.A .
- Certificate familjare me kryefamiljar A.A, dt. 02.03.2021.
- Kopje pasaporte në emër të E A.

✚ **Në mënyrë të përmbledhur subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar deri më 28.04.2023 si më poshtë:**

1. Autoveturë tip Mazda me targa AA***SV përfituar me kontratë dhurimi. Zotëron 100 %
2. Shtëpi banimi me sip.79.64 m2, me adresë në Rrugën "****" blerë nga enti kombëtar i banesave në vitin 2013, në vlerën 15.314 lekë. Zotëron 100% me djalin dhe bashkëshorten.
3. Truall me sip.378.04 m2, përfituar nga ASHK në vitin 2021, në bazë të VKM nr.827, dt.30.09.2020.
4. Gjendje cash në emër të subjektit, vlera 150.000 lekë.
5. Llogari page në Credins Bank në emër të subjektit me balancë 749 lekë.

6. Llogari page në BKT, në emër të vajzës T.A me balancë -67.579 lekë.
7. Autoveturë Volsvagen Polo me targë AA*** SJ, në emër të bashkëshortes, blerë në vitin 2017, në vlerën 5.040 euro.
8. Llogari page ne OTP, në emër të bashkëshortes me balancë 817.627 lekë.
9. Llogari page ne Intesa Sanpaolo Bank, në emër të djalit, me balancë 52 lekë.

Vlera e pasurisë bruto/neto është 983.742 lekë + 5.040 Euro, e konvertuar rreth 1.544.000 lekë. (Vajza e subjektit ka detyrim overdrafti në llogarinë e pagës në BKT, në shumën rreth 68.000 lekë, e pa përfshirë në vlerën e pasurisë). (Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH, të datës 28.04.2023, ku 1 Euro = 111.12 lekë)

✚ Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar & Shqipërisë, Procredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Banka Union, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing sh.p.k, Landeslease sha, Raiffeisen Invest, Credins Invest, EasyPay, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Kredo. AI; konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre.

✚ ASHK, Zyrat / Drejtoritë Vendore: Librazhd, Zonat e Stimuluara Tiranë, Kamzë Vore, Tirana Veri, Tirana Rurale 1, Tirane Rurale 2, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Kuçovë, Puke, Malësi c Madhe, Kukës, Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Krujë, Elbasan, Kolonjë, Has, Bulqizë, Durrës, Skrapar, Peqin, Tropojë, Mirditë, Tepelenë, Përmet, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Gramsh, Gjirokastrë, Mat, Sarandë, Dibër dhe Kurbin, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme te regjistruara ne emër te subjektit dhe personave të lidhur.

✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të I.A , për periudhën 2016 - 2018, në të cilën është disbursuar kredi në shumën 94.903 lekë, në dt.09.09.2016, e cila është mbyllur në dt.18.09.2018.

✚ Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., date 31.07.2023, konfirmon llogari page në emër të Arben Alike për periudhën gusht 2010 - 18.04.2018. Konfirmohet depozitë në monedhën euro, hapur në dt. 29.12.2010, në shumën 1.846 euro, mbyllur në dt.11.10.2011, ku është tërhequr shuma 1.867 euro.

✚ ABI Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon llogari page në emër të I.A , për periudhën 09.11.2020 - 28.04.2023, me balancë në dt. 28.04.2023, në shumën 7 lekë. Konfirmohet diskursi kredie ne dt. 18.11.2022, në shumën 100.000 lekë. Balanca e llogarisë në dt. 28.04.2023, në shumën 81.143 lekë.

→ *Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se qëllimi i marrjes së kësaj kredie ka qenë për nevoja familjare. Nuk është deklaruar, se është menduar si kredi konsumatorë me një vlerë relativisht të vogël dhe shlyerja bëhej nga llogaria e pagës së djalit.*

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me qëllimin e marrjes së kredisë në ABI Bank me detyrim të mbetur në shumën 81.143 lekë.**

✚ Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon se për periudhën 28.04.2018 - 28.04.2023, në emër të I.A , rezultojnë 3 transaksione në hyrje, ku është tërhequr

shuma totale 465 euro dhe 3 transaksione në dalje, ku janë dërguar në total 26.120 lekë. Në emër të T.A, rezultojnë 2 transaksione në hyrje, ku janë tërhequr në total 600 euro dhe 1 transaksion në dalje, ku është dërguar shuma 5.000 lekë.

✚ AK-Invest, me shkresën nr.*** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se T.A ka kryer një transaksion si përfituese, në shumën 6.115 lekë, në dt. 26.12. 2022, me dërgues H D nga G.B.

→ Në proces verbalin e datës 03.11.2023, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion në lidhje me këto transaksione, por ka shpjeguar se djali i tij ka kryer veprime me vjehrrin e tij (babai e b/shortes P.M që banon dhe jeton në Vlorë) dhe gjithashtu djalin e dajës që banon në Greqi, B Sh dhe nënën e tij A K. Transaksionet janë në shumën të vogla të cilat kanë pasur si burim të ardhurat e tij. Ndërsa përsa i përket hyrjeve, shumën e dërguar kanë pasur si qëllim, thjesht marrëdhëniet familjare. Ndërsa Tea ka pasur dërgesa nga halla e saj në Itali, nga kushëriri B.Sh, në Greqi dhe shoqja e kushëririt H. D. Dërgesat kanë qenë në shumën të vogla dhe kanë pasur si qëllim blerjet e ndryshme. Nuk disponojmë dokumentacion.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me transaksionet e konfirmuara nga Unioni Financiar dhe AK-Invest.**

✚ Iute Credit, me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2023, konfirmon se djali I.A ka qenë kredimarrës në vlerën 26.000 lekë, me datë disbursimi 22.12.2018, me afat 8 muaj. Aktualisht me status mbyllur.

✚ QKB, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizike apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

✚ D. P. Tatimeve, me shkresën nr. V-prot., datë 02.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.

❖ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 28.04.2023, është deklaruar bruto/neto në shumën 983.742 lekë + 5.040 Euro, e konvertuar rreth 1.544.000 lekë.

✓ Të ardhurat neto të subjektit nga paga dhe shpërblime, për periudhën gusht 1990 – prill 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 16.604.000 lekë.

✓ Të ardhurat neto të b/shortes nga pagat, për periudhën nëntor 2007 - prill 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 7.775.000. lekë

- ✓ Të ardhurat neto nga paga e vajzës T.A për periudhën prill 2016 - prill 2023, në vlerën totale rreth 1.689.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto nga paga e djalit I.A , për periudhën korrik 2015 - prill 2023, në vlerën totale rreth 4.828.000 lekë.
- ✓ Dhuratë automjeti me targë AA***SV, me vlerë tregu 3.000 euro, nga vëllai i subjektit në vitin 2022.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth 192.000 lekë. Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime rreth 700 Euro, konvertuar rreth 78.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total rreth 462.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në v. 2016, janë shpenzuar për ndërtim dyqani rreth 210.000 lekë, si dhe për arredim dhe rikonstruksion banese rreth 1.827.000 lekë, në total rreth 2.037.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 2000 - prill 2023, referuar treguesve statistikore te INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 15.819.000 lekë.

28. **Në përfundim të hetimit të kryer:** Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Arben Alika:

- ✓ ***Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;***
- ✓ ***Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;***
- ✓ ***Nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
- ✓ ***Nuk është kryer deklaram i rremë;***
- ✓ ***Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit;***

II. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

- ❖ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:
 1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

❖ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **Z. Arben Mehmet Alike**, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

❖ **Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administruar pranë trupës më datë me shkresën nr.*** prot datë 19.12.2023.

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Të dhënat e paraqitura në Deklaratën për Kontrollin e Figurës janë të sakta dhe të vërteta.
- Është i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të sjell përjashtimin nga detyra, sipas ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, të ndryshuar.

Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar. Pas shqyrtimit paraprak të formularit të deklaramit u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në Drejtorinë e Analizës dhe Kartotekës referuar nenit 42 të ligjit 12/2018 i ndryshuar

Hetimi administrativ

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, janë kryer veprime duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në ligj, referuar nenit 37 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Nga informacionet e dërguara nga institucionet e mësipërme konstatohet se:

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I Kufizuar” me nr. prot.*** datë 07.08.2023, bën me dije se:
 - *Shtetasi Arben Alike ka lindur më 26.07.1968, në Tepelenë sipas aktit të lindjes me nr.***, datë 15.08.1968 me të dhënat **Arben Alike**. Nga verifikimet e kryera në RKGJC rezulton me të dhënat Arben Alike,*
 - *Aktualisht figuron i regjistruar në ZGJC- Njësia administrative nr *** Tiranë, Bashkia Tiranë, Regjistri Themeltar “****”, *** ref., që prej datës 28.12.2004, kur është vendosur me transferim nga ZGJC NJA ***, Bashkia Tiranë, regjistri themeltar “pa adresë”, 01/***.*
 - *Nga verifikimi rezulton se në Njësinë Administrative nr.*** është vendosur i ardhur nga Tepelena me datë 30.10.1995, Libri *** ref. me të njëjtët përbërës të gjendjes civile.*
 - *Ka ndryshuar statusin nga “beqar” në “i martuar” me shtetasen T.ALIKA .*
 - *Nuk ka ndryshuar apo marrë shtetësi tjetër.*
 - *Nga verifikimet në ZGJC Tepelenë, rezulton se nuk ka kryer asnjëherë ndryshime, korigjime në përbërësit e gjendjes civile.*
 - *Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të tjera të subjektit të vlerësimit.*

2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën “I Kufizuar” nr.*** datë 28.07.2023, konfirmon se nuk rezulton i dënuar.
3. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “Sekret” datë 15.08.2023, konfirmon se nuk disponon të dhëna.
4. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar” datë 11.08.2023; konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Arben Alike, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare:
 - a. Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - b. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
 - c. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, te nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar);
 - d. Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale;
 - e. Nuk ka të dhëna nëse ka qënë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - f. Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-
 - i. Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - j. Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore
5. **Organ Ligjzbatues** me shkresën nr.*** datë 31.05.2023 konfirmon se nuk disponon të dhëna.
6. **Institucion Ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr.** datë 09.08.2023;nr.** datë 06.10.2023; me shkresën “I Kufizuar” nr *** dt.16.08.2023 bën me dije se për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të:
 - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundraligjshëm
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara.
 - c. Nuk disponohen ankesa, të dhëna apo informacione që lidhen me objektin e kërkesës për subjektin e vlerësimit.
7. **Organ Ligjzbatues** me shkresën “I Kufizuar” nr.***, datë 27.09.2023 , konfirmon se:
 - a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;

- d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - e. Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
8. **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 10.08.2023 bën me dije se nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal.
9. **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**, me shkresën nr.*** datë 03.08.2023, konfirmon se ka raportime financiare rutinë për subjektin dhe bashkëshorten e tij.
10. **AKSIK**, i cili me shkresën “I Kufizuar” me nr. ***, datë 31.07.2023, konfirmon se subjekti është i pajisur me certifikatë sigurie “Tepër Sekret” të vlefshme deri më 05.05.2026 si dhe nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
11. **Avokati i Popullit**, me shkresën “E Paklasifikuar” datë 14.08.2023 bën me dije se:
- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
 - b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.
12. **Autoriteti për informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** , për subjektin e vlerësimit **Arben Mehmet Alik**a bën me dije se:
- Nuk ka qënë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish Sigurimi i Shtetit deri me 2 Korrik 1991.

❖ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se: **nuk u zbulua** prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (kokaine), MTD (metadon), THC (canabioide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricyklike antidepressantë, AMF (amfetaminë), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

29. **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Arben Alik,:

- ✓ *Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- ✓ *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- ❖ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- ❖ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
 - a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar,
 - b. Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardet profesionale në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- ❖ Subjekti i vlerësimit Z. Arben Alika,, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zv/Drejtorit për hetimin e krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë, Gjirokastër në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit.
- ❖ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës.
- ❖ Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr.12/2018, (i ndryshuar) bazuar në nenet 43 - 46, të po këtij ligji. Arben Alika, është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar dhe aktualisht mban detyrën e Zv/Drejtorit për hetimin e krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë, Gjirokastër në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit, bazuar në urdhrin e emërimit, nr. ***, datë 25.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ❖ Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
- ❖ Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44-46, duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatorë e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.
- ❖ Trupa Vlerësuese përdori si burime për vlerësimin e saj, fillimisht :
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

- Më tej, të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.
 - Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale.
- ❖ Subjekti i vlerësimit Arben Alike, ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.
- Janë marrë në konsideratë për vlerësimin e nivelit arsimor.
 - Të dhënat që janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. 17***.
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS.
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
 - Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
 - Të dhënat e siguruar nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse.

Niveli arsimor	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundim	Vendi	Titulli/Diploma
I lartë	Shkolla dy vjeçare	1988	1990	Tiranë	Diplomë
I lartë	Akademia e Policisë	1994	1998	Tiranë	Diplomë

❖ **Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese:**

Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, *ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.*

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit rezultojnë se subjekti ka kryer edhe trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe Workshop-e të ndryshëm.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezultojnë se ai ka kryer trajnimet/specializimet si më poshtë:

Nr. Viti		Emërtimi i trajnimit	Lloji i Dokumentit
1.	1998	Kurs bazë tre mujor për trajnimin e policisë	Certifikatë
2.	2003	Kurs Investigimi i çështjeve të nxehta të vrasjeve	Certifikatë
3.	2004	Krimi në fushën e vjedhjes së automjeteve.	Certifikatë
4.	2004	Kursi i analizës dhe kriminalistikës së Inteligjencës	Certifikatë

Në dosjen personale të subjektit për periudhën 2018-2023 rezulton se janë administruar 2 (dy) vlerësime pune, tre mungojnë.

Trupa e Vlerësimit ka kërkuar të dhëna shtesë DPPSH, për procesin e vlerësimit kalimtar për subjekti z. Arben Alika,.

Për periudhën 2018-2022 është vlerësuar si vijon:

- | | | |
|----|--|-----------------------|
| a. | Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2018 | 28 pikë (shumë mirë) |
| b. | Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2019 | ska |
| c. | Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2020 | ska |
| d. | Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021 | 28 pikë |
| e. | Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2022 | ska |

Për periudhën e fundit 5(pesë) vjeçare 2018-2023 të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinisht me masë disiplinore.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

Bazuar në vlerësimet e mësipërme trupa vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

Konkretisht:

- ✓ 16.03.2016-26.05.2017: Shef seksioni tekniko shkencor dhe depërtimin e operacioneve Tiranë.
- ✓ 26.05.2017-25.02.2020: Shef komisarati i Policisë Shijak.
- ✓ 25.02.2020-29.10.2021: Shef Sektori i Shërbimeve policore të Specializuara DVP Durrës.
- ✓ 29.10.2021-27.03.2023: Specialist në Njësinë për Hetimin e Krimeve të Rënda DPPSH.
- ✓ 27.03.2023 e Aktualisht ZV/Drejtor për Hetimin e Krimeve DVP Gjirokastrë

Ecuria në Gradë e Subjektit të Vlerësimit Z. Arben Alika:

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.*** dt.07.02.2019, “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie Komisar z. Arben Alika, i cili është shpallur fitues në konkurrimin për gradën policore “Kryekomisar”, i jepet grada policore “Kryekomisar”, Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

Nga shqyrtimit i dokumentacionit në dosjen e subjektit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.*** dt. 07.02.2019, “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie Komisar z. Arben Alika, i cili

është shpallur fitues në konkurrimin për gradën policore “Kryekomisar”, i jepet grada policore “Kryekomisar”, Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

Emërtimi Gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
				Deri
Kryekomisar	Ngritur në gradë	Nr.151	07.02.2019	aktualisht

Në përfundim të hetimit të kryer, Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Arben Alike,:

- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike datë 31.10.2024, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Arben Alike, në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,**
- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,**
- **Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.**

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit e AMP, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. **Arben Mehmet Alike**, me funksion, Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Policisë Vendore Gjirokastrë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **07.11.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesues

Arben SEFAJ

Relatore

Denisa SINA

Anëtare

Suela BULKU

